



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOMISIONI PËR BANESA, Prishtinë

NJOFTIM

Agjencia Kosovare e Privatizimit ("Agjencia"), bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1, të Ligjit për Shitjen e Banesave mbi të cilat Ekziston e Drejta Banesore Ligji Nr.04/L-061 (" Ligji për Shitjen e Banesave"), ka mandat për shitjen e banesave në pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore. Me Ligjin për Shitjen e Banesave rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, për të cilat ekziston e drejta banesore.

Ky njoftim publikohet me qëllim të informimit të palëve të cilët kanë paraqitur kërkesë për blerjen e banesës pranë Agjencisë,dhe me të cilët ka qenë i perealizueshëm komunikimi përmes postës.

Kerkesa nr. KB-251/12 e paraqitur nga Hysen Kelmendi person i autorizuar nga Jusuf Kelmendi.

Pas shqyrtimit të dëshmimeve dhe dokumentacionit në dispozicion të bashkangjitur kërkesës së palës për privatizim të banesës me KB-251/12, Bordi i Agjencisë me Vendimin **Nr.Ref.BD-100/5** e ka refuzuar kërkesën në fjalë.

Arsyetim ligjor

Në zbatim të Nenit 13 të Ligjit për Shitjen e Banesave, për kërkesën në fjalë, Agjencia ka siguruar konfirmimin nga Agjencia Kosovare e Pronës (KPA). Me vendimet e plotfuqishme të Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore HPCC/REC/81/2006, të datës 12.12.2006 dhe KPCC/D/R/231/2014 të datës 13.03.2014 pales ju është refuzuar kërkesa për kthimin e posedimit të ligjshëm të banesës cila është objekt i kërkesës për privatizim. Në pajtim me nenin 13 paragrafi 2, të Ligjit për Shitjen e Banesave, Agjencia si shitëse, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për blerjen e banesës, është e obliguar të zbatoj Vendimin e Agjencisë Kosovare të Pronës (KPA) respektivisht të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (HPD) si pararendëse e saj.

Kërkesa nr. KB- 149/12, e paraqitur nga Nexharije Berisha në cilësinë e bartëses të së drejtës banesore.

Pas shqyrtimit të dëshmive dhe dokumentacionit në dispozicion të bashkangjitur kërkesës së palës për privatizim të banesës me KB-149/12, Bordi i Agjencisë me Vendimin **Nr.Ref.BD-82/15** e ka refuzuar kërkesën në fjalë.

Arsyetimi ligjor

Banesa përkatësisht baraka për të cilën pala ka paraqitur kërkesë për blerje në bazë të Nenit 6 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86, nuk konsiderohet banesë dhe për këtë arsye pala nuk arritur që të lidhë Kontratë për Shfrytëzim me ish BVI dhe rrjedhimisht nuk i plotëson kushtet e parapara me Nenin 3 paragrafi 1.6 të Ligjit për Shitjen e Banesave e lidhur me Nenin 2 dhe 11 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore(Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).

Kërkesa nr. KB- 481/13, e paraqitur nga Manika (Oroshi) Kraja në cilësinë e personit të autorizuar nga Karolina Tomic.

Pas shqyrtimit të dëshmive dhe dokumentacionit në dispozicion të bashkangjitur kërkesës së palës për privatizim të banesës me KB-481/13, Bordi i Agjencisë me Vendimin **Nr.Ref.89/11** e ka refuzuar kërkesën në fjalë.

Arsyetimi ligjor

Në zbatim të Nenit 13 të Ligjit për Shitjen e Banesave, për kërkesën në fjalë, Komisioni ka siguruar konfirmimin nga Agjencia Kosovare e Pronës (KPA). Me vendimin e plotfuqishëm të Drejtorisë për Qështje Pronësore Banesore HPCC/D/194/2005/C të datës 18 Qershor 2005 , palës i është refuzuar kërkesa për këthim të posedimit mbi banesën objekt i kërkesës për privatizim. Në pajtim me nenin 13 paragrafi 2, të Ligjit për Shitjen e Banesave, AKP si shitëse, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për blerjen e banesës, është e obliguar të zbatoj Vendimin e Agjencisë Kosovare të Pronës (KPA) respektivisht të Drejtorisë për çështje Pronësore dhe Banesore (HPD) si pararendëse e saj.

Kërkesa nr. KB- 1225/14, e paraqitur nga Milijana Petkovic në cilësinë e bartëses të së drejtës banesore.

Pas shqyrtimit të dëshmive dhe dokumentacionit në dispozicion të bashkangjitur kërkesës së palës për privatizim të banesës me KB-1225/14, Bordi i Agjencisë me Vendimin **Nr.Ref.85/7** e ka refuzuar kërkesën në fjalë.

Arsyetimi ligjor

Parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të argumentoj me anë të provave se është bartëse e së drejtës banesore edhe pas dërgimit të kërkesës për dokumente shtesë

nga AKP-ja. Parashtruesja e kërkesës posedon Vendimin nr. 374 të datës 21.10.1996, , mbi shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës afariste ne Rr. Vojvode Stepa Stepanovic p.nr. me sip. 16 m2 , ku sipas pikës dy të njëjtit vendim pala (shfrytëzuesja) obligohet që hapësirën afariste ta lironte brenda afatit prej 30 ditësh nëse hapësira do të ishte e nevojshme për nevojat e ndërmarrjes Germia. Rrjedhimisht pala nuk i plotëson kushtet për privatizimin e banese sipas nenit 1 te Ligjit për Shitjen e Banesave i cili parasheh " *Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi shoqërore dhe publike për të cilat ekziston e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë të pacaktuar...*". Gjithashtu pala nuk ka prezantuar Kontratën për shfrytëzimin e banesës me BVI apo ndërmarrjen, sikurse parashihen në neni 3 paragrafi 1.6 të Ligjit për Shitjen e Banesave e lidhur me Nenin 37 dhe 38 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).

Shënim i rëndësishëm:

Pala e pa kënaqur me Vendimin e Bordit, udhëzohet që ti përdor mjetet juridike pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 30 të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 04/L-034) dhe nenin 6 paragrafi 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (Ligji nr. 04/L-033).